


# NE PUNOJMË



# PËR TË ARDHMEN

## NE VLEJMË

ALBINA (13), VESA (14), ELDA (13), ADEA (13), EDI (13), LORENT (13), JETMIR (13)



### Fillet e demokracisë, toleranca dhe qytetaria aktive

Në botë toleranca duhet të jetë prioritet, pasi që nëse ne nuk kemi tolerancë, atëherë tregohet se nuk jemi të aftë të respektojmë njëri-tjetrin. Kjo mund të na sjell në konflikte të shumta, e ne e dijmë se konfliktet nuk sjellin asnjë të mirë. Toleranca tregohet kur ti je i aftë të pranosh dallimet, idetë, mendimet dhe zgjedhjet e dikujt tjetër. Ajo është mirëkuptimi ndaj njëri-tjetrit, është dëshira për të punuar së bashku në mënyrë që të gjendet një zgjidhje e përbashkët.

Demokracia është pjesë e vendit tonë. Fjala demokraci rrjedh nga fjalët greke „demos“ popull dhe „kratia“ qeverisje, që do të thotë qeverisje nga populli. Demokracia u paraqit për herë të parë në Athinë, në kryeqytetin e Greqisë. Më herët, demokracia ishte shumë më ndryshe se sa që është tani. Atëherë të drejtën e votës e kishin vetëm burrat e pasur.

Gratë dhe skllevërit (të varfërit) nuk e kishin fare të drejtën e votës. Me kalimin e kohës, demokracia ndryshoi dhe tani të gjithë personat mbi moshën 18 vjeçare, e kanë të drejtën e votës. Demokracia si sistem i qeverisjes, në tërë vendet e botës ndahet në përfaqësuese dhe direkte. Në shtetin tonë Kosovën ekziston demokracia përfaqësuese. Ky lloj i demokracisë nënkupton se populli voton disa deputetë të caktuar për qeverisje. Qytetari është anëtar i një komuniteti, pavarësisht nëse jeton në fshat apo qytet. Ai gjithnjë është qytetar i vendit të tij. Qytetaria aktive ka rol të rëndësishëm në demokraci.

Qytetari duhet të jetë aktiv në çdo fushë për të mirën e tij, dhe po ashtu edhe për të mirën e vendit. Ai mund të jetë aktiv duke mbledhur mbeturina apo duke marrë pjesë në peticione. Për shembull, kur një lagje ka probleme me elektricitet atëherë të gjithë qytetarët e nënshkruajnë atë peticion. Qytetarët aktiv po ashtu ndihmojnë personat me nevoja të veçanta.


Të drejtat janë disa norma, të cilat neve na garantojnë siguri. Të gjitha të drejtat e qytetarëve në demokraci garantoohen me ligj. Kurse përgjegjësitë janë detyra të një personi, të cilat ai nuk është i detyruar t'i kryej por e bën me vetë dëshirë. Përgjegjësitë është gjithmonë mirë t'i kryejmë. Ne mendojmë se duhet respektuar të tjerët që të të respektojnë.



Gazetarët e rinjë



Grupet gjatë punëtorisë



E drejta e votimit i takon secilit




Të gjithë të barabartë



Grupi duke diskutuar për zgjedhjet



Gazetarët duke punuar në artikull



Demokracia është paqe

# LLOJET E PUSHTETIT DHE FUNKSIONI I TYRE

LINDA (13), EGZON (13), ELZA (13), LEONDRIT (12), NITA (13), ENES (13)

## Sot kemi mësuar dhe diskutuar për ndarjen e pushtetit dhe arsyet pse ndahet pushteti

Pushteti është forca apo e drejta që i jepet një personi apo një grupi individësh, në mënyrë që të zhvillohet rendi dhe rregulli. Në demokraci, pushteti vendoset dhe zgjedhet nga vetë ne si qytetarë. Pushteti ndahet në: Pushtetin Legjislativ, Pushtetin Ekzekutiv dhe atë Gjyqësor.

Pushteti Legjislativ përfaqësohet nga Kuvendi cili miraton ligje. Në Kuvend marrin pjesë gjithsej 120 deputetë, të cilët zgjedhen nga shumica e votave të popullit. Deputetët kanë për detyrë që të zgjedhin kabinetin qeveritar, si dhe kanë të drejtën të kontrollojnë Qeverinë dhe punën e saj. E kanë këtë të drejtë, sepse janë zgjedhur nga vetë ne si qytetarë.

Pushteti Ekzekutiv është pushteti, i cili bën ekzekutimin e ligjeve dhe i vë ligjet në jetë. Vendi ku funksionon ky lloj i pushtetit është Qeveria. Në Qeveri, mi-


nistrat e ndryshëm i vëjnë në funksion ligjet e nxjerra nga Legjislativi. Qeveria ka ministri të ndryshme si: Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Infrastrukturës, Ministria e Bujqësisë, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, etj.

Pushteti Gjyqësor është pushteti i cili sigurohet se ligjet po respektohen, në mënyrë reciproke. Vendi ku kryhet ky funksion janë gjykatat. Kemi tri lloje të gjykatave, që janë: Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme. Të tri këto gjykata kanë funksion të njëjtë, por trajtojnë raste të ndryshme.

Ndarja e pushtetit është shumë e rëndësishme në një shtet me udhëheqje demokratike. E gjithë kjo bëhet për të mbajtur balancën dhe që gjithçka të jetë në rregull.



Gjykata Supreme



Qeveria e Kosovës

Pushteti i Legjislativ	Pushteti Ekzekutiv	Pushteti Gjyqësor
Perfaqëson Shtetin dhe Popullin	Jekzekutojnë ligjet	Gjykata e Apelit
Miraton, Shfuzizon dhe Propozon ligje	Udhëheq Ministrinë	Gjykata Themelore
Mbikëqyon Punën e Qeverisë	Udhëheqet nga kryeministri	Gjykata Supreme
Zgjedh Qeverinë dhe Presidentin	Raporton për punën e bërë Kuvendit	Përkrahësit që ligjet të respektohen nga qytetarë

Ndarja e pushtetit



Gazetarët e Kuvendit të Kosovës

# ROLI I ZGJEDHJEVE NË DEMOKRACI


ERON (14), VANESA (14), OLTİ (14), BUTRINT (13), DIELLZA (13), ELIZA (13), EMA (13)

## Çfarë roli kanë zgjedhjet në demokraci?

Zgjedhjet kanë rol të rëndësishëm në jetën e përditshme të qytetarëve, sepse me anë të tyre zgjedhen përfaqësuesit e vendit. Përfaqësuesit apo ndryshe deputetët, përmes punës së tyre ia mundësojnë popullit një jetë sa më të mirë. Në zgjedhje kanë të drejtë të marrin pjesë qytetarët nga moshë 18 vjeçare. Kjo për shkak se mendohet se që nga ajo moshë e arrijmë pjekurinë mendore. Zgjedhjet mbahen çdo 4 vjet, por nëqoftëse populli nuk është i kënaqur me atë qeverisje mund të ndodhin edhe zgjedhjet e parakohshme. Dhënia e votës nuk është e detyrueshme, por është përgjegjësi morale e çdo qytetari nëse ai dëshiron të ketë një të ardhme sa më të mirë në vendin e tij. Pra, përmes zgjedhjeve çdo qytetar shprehet i lirë dhe në këtë mënyrë ndërtohet edhe demokracia.




Demokracia në veprim



Informacionet tona për zgjedhjet



Ne duam të jetojmë në paqe



Parimet e demokracisë



Mënyra më e mirë për shprehjen e demokracisë



## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPËSTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:  
Tel: +381 38 704 560  
E-mail: [info@demos-ti.org](mailto:info@demos-ti.org)  
Website: [www.demos-ti.org](http://www.demos-ti.org)

Pjesëmarrësit:  
SHFMU „Nazim Gafurri“  
Klasa: VIII-4  
Vendi: Prishtinë